



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:097343
Datë: 26.07.2024
Numri i dokumentit: 05987177

K.Dh.Shk.II.nr.1389/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Imeri, kryetare e kolegjit, Ramush Bardiqi, dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit/propozuesve të masës së sigurisë 1. N.P.T “Boss&Com” me NUI 811647439, me seli në Fushë Kosovë, dhe 2. E.M. nga fshati Jovic, Komuna Malishevë, të cilit i përfaqëson sipas autorizimit Avokat Editon Osmani, kundër të paditurve/kundërshtarëve të masës së sigurimit 1. Banka Kombëtare Tregtare Sh.A me NUI 810543399, me seli në rrugën “Ukshin Hoti”, Prishtinë të cilin e përfaqëson sipas autorizimit I.S., 2. I.H. nga fshati Carallukë, Komuna Malishevë, dhe 3. SH.H. nga fshati Carrallukë Komuna Malishevë të cilit sipas autorizimit i përfaqëson Avokat Besnik Berisha me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesve të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e shkallës së parë - Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.19/24 e datës 14.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e propozuesve të masës së sigurimit 1. N.P.T “Boss&Com” shpk me seli në Fushë Kosovë, 2. E.M., me seli ne nga fshati Jovic, Komuna Malishevë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.19/24 e datës 14.06.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e ankimuar KP.nr.19/24 e datës 14.06.2024, në dispozitiv të aktvendimit e ka Refuzuar në tërësi si e pa bazuar propozimi i propozuesve të masës së sigurimit 1. N.P.T “Boss&Com” dhe 2. E.M., me të cilën kanë kërkuar që ndaj kundërshtarëve të masës së sigurimit 2. I.H. dhe 3. SH.H. të caktohet masë e sigurisë ashtu që ti ndalohej që ta tjetërsojë, fshehtë, ngarkojë ose disponoj me pasurinë apo në çfarë do forme të ndryshoj gjendjen aktuale në parcelën kadastrale nr. P-... ZK Malishevë, arë e klasit të pestë, sipërfaqe prej 3500 m2, me numër të listës poseduese 06-550-2021, derisa të vendoset në mënyrë meritore për çështjen kryesore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i sigurimit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e shkallës së dytë, aktvendimin KP.nr.19/24 e datës 14.06.2024 ta anuloj dhe të aprovohej propozimi i propozuesit dhe ti ndalohej kundërshtarëve të sigurimit që ta tjetërsojë, fshehtë, ngarkojë ose disponojë me pasurinë apo çfarë do forme të ndryshoj gjendjen aktuale parcelën në parcelën kadastrale nr. P-..., Zona Kadastrale Malisheve e cila gjendet në Malisheve, lloji i njësisë parcele me përdorim aktual arë e klasës së pestë, sipërfaqes 3500 m2, e regjistruar në çertifikatën e të drejtave të pronës së paluajtshme të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyra Kadastrale Komunale me nr.06-550-2021, apo lenden të kthejë në rivendosje dhe rigjykim, në gjykatën e shkallës së parë.

Kundër propozuesi i sigurimit ka ushtruar përgjigje në ankesë ku ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa themeltë, dhe të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.19/24 e datës 14.06.2024

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë e pas vlerësimit të tyre veç e veç dhe në lidhshmëri të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Paditësit - Propozuesit të masës së sigurimit 1. N.P.T “Boss&Com” dhe 2. E.M., përmes të autorizuarit të tyre, më datën 27.03.2024 pranë kësaj Gjykate kanë parashtruar padinë dhe propozim për caktimin e masës së sigurimit, kundër të paditurve/kundërshtarëve të masës së sigurimit 1. Banka Kombëtare Tregtare Sh.A, 2. I.H., dhe 3. SH.H., sipas padisë ka kërkuar anulimin e urdhrit P.nr.239/15 të përmbauesit privat të datës 19.12.2016, anulimin e kontratës mbi shitë-blerjen patundshmërisë Nr.LRP.236/2021 dhe nr. Ref 236/2021 të datës 29.09.2021, dhe regjistrimin e pronës në emër të paditësit E.B. Morina, derisa të vendoset në mënyrë meritore për çështjen kryesore.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e ankimuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 297 par.1 pika a) dhe b) dhe nenit 301 të LPK-së, si dhe duke arsyetuar aktvendimin e ankimuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurisë.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë e mori këtë qëndrim juridik sepse sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” *Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do*

ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet ligjore, sipas të cilave propozuesi i sigurimit duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës si dhe ta bëjë të besueshme faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së tij, e që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar me të drejtë ka vendosur se nuk janë përmbushur kushtet ligjore sipas nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, andaj dhe ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Propozuesi i masës së sigurimit me propozim ka kërkuar sigurimin e palujshmëris me nr.P-... Zona Kadastrale Malishevë, e cila gjindet në Malishevë, lloji i njesisë parcele, me përdorim aktual are e klasës 5, në sipërfaqe prej 3500m², ashtu që kundërshtarëve të sigurimit t’iu ndalohej që të tjetërsojë, fshehë, ngarkoj ose disponoj me pasurinë, apo çfardo forme të ndryshoj gjendjen aktuale, ndërsa me padi ka kërkuar që anulohet urdhëri përmbarimor P.nr.239/15 datës 19.12.201, si dhe të anulohet kontrata për shitëblerjen e patundshmërisë nr.LRP.236/2021 dhe nr.Ref.236/2021 datës 29.09.2021 e lidhur në mesë të paditurës Banka Kombëtare Tregtare me seli në Prishtinë dhe të Paditurit I.H. dhe SH.H..

Andaj, Kolegji i Dhomës së Shkallës së dytë, i ka analizuar të gjitha provat që gjinden në shkresat e lëndës si dhe pretendimet ankimore por erdhë në përfundim se për palujshmërin me të cilën kërkohet caktimi i masës së sigurisë, ndaj kundërshtarëve të sigurimit I...dhe SH.H. nga fshati Carrallukë, Komuna e Malishevës, kjo palujshmëri ka kaluar dhe është bartur në pronësi të tyre sipas kontratës së shitëblerjes të datës 29.09.2021 me nr.LRP236/2021,REF236/2021 e vërtetuar në zyrën e noterit Minir Zekolli në Suharekë dhe atë sipas çertifikatës-Njësia Kadastrale P-.... Kështu në bazë të kontratës mbi shitëblerjen e palujshmërisë në fjalë, shifet se kjo palujshmëri me nr.P-... Zona Kadastrale Malishevë, e cila gjindet në Malishevë, lloji i njesisë, parcele, me përdorim aktual are e klasës 5, në sipërfaqe prej 3500m² janë në posedim tek kundërshtarët e sigurimit në bazë të një punë juridike të vërtetuar tek noteri, andaj nëse aprovohet masa e propozuar që në fillim e paragjykon çështjen kryesore dhe mu për këtë gjykata ka vendos që të refuzoj ankesën e propozuesit të masës së sigurisë dhe ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar,

ngase me një masë të till do të mund të preken të drejtat pronësore të personave që nuk janë drejtë për drejtë të lidhur me çështjen por që pronat e tyre janë objektë e çështjes që kërkohet të sigurohen me masë të sigurisë.

Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoj edhe pretendime tjera ankimore lidhur me atë se propozuesi i masës së sigurisë është zhveshur në mënyrë të kundërligjshme nga e drejta e tij në pronë, këto pretendime nuk mund të jenë objekt shqyrtimi lidhur me vendosjen për masë të sigurisë, pasi që pretendimet e tilla propozuesi do të mund që ti mbështes me prova përkatëse në çështjen kryesore.

Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b), për caktimin e masës së sigurisë.

Andaj, bazuar në të lartcekurat dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke vërtetuar vendimin e gjykatës së shkallës ë parë.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë,

K.Dh.Shk.II.nr.1389/2024, dt. 25.07.2024

Kryetare e kolegjit
Francika Zhitija Ymeri